**РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
**АГЕНЦИЈА ЗА КВАЛИТЕТ ВО ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ**
**ОДБОР ЗА АКРЕДИТАЦИЈА НА ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ**

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**
**AGJENCIA PËR CILËSI NË ARSIMIN E LARTË**
**BORDI PËR AKREDITIM I ARSIMIT TË LARTË**

08-349/6
04.12. 23

Врз основа на член 48 став (2) точка 6, член 145 став (2) и член 227 од Законот за високото образование („Службен весник на Република Македонија" бр. 82/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија" бр. 178/21), Одборот за акредитација на високото образование на Република Северна Македонија, на својата **17-та** седница, одржана на **5.5.2021** година, донесе:

# РЕШЕНИЕ

## за акредитација на Студиската програма „Градежништво", втор циклус на академски студии - постдипломски студии (60 ЕКТС), на Факултет за применети науки при Универзитет во Тетово

1. Се акредитира Студиската програма **„Градежништво"**, втор циклус на академски студии - постдипломски студии (60 ЕКТС), на Факултетот за применети науки при Универзитет во Тетово, согласно Законот за високото образование*, Уредбата за нормативите и стандардите за основање на високообразовни установи и за вршење високообразовна дејност („Службен весник на Република Македонија" бр. 103/10, 168/10 и 10/11) и Класификацијата на научно-истражувачки подрачја, полиња и области според Меѓународната фраскатиева класификација (дадена како Прилог 1 на наведената Уредба).

2. Акредитацијата за Студиската програма од точка 1 на ова решение е за период од пет студиски години, почнувајќи од академска **2021/2022** година.

3. По завршување на студиите на Студиската програма од точка 1 од ова решение, студентот се стекнува со 60 ЕКТС кредити и се стекнува со академскиот назив: **Магистер по технички науки од областа на градежништво** / во меѓународниот промет академскиот назив: **Master of Sciences in Civil Engineering.**

4. Научно-истражувачко подрачје: 2 Техничко-технолошки науки
Научно-истражувачко поле: 207 Градежништво и водостопанство
Научно-истражувачка област: 20700 Градежни материјали, 20701 Геотехника, 20702 Градежни конструкции во ниско и високо градбата, 20703 Земјотресно инженерство 20704 Компјутерска интеракција при проектирање и градење на објекти, 20705 Механика на цврсто и деформабилно тело, 20706 Теорија на конструкции, 20707 Челични конструкции, 20708 Бетонски, армиранобетонски и преднапрегнати конструкции, 20709 Патишта и аеродроми, 20711 Тунели, 20712 Хидрологија, 20713 Хидраулика, 20714 Комунална хидротехника и заштита на водите, 20715 Уредување на водотеците и заштита од ерозија, 20716 Хидротехнички мелиорации, 20717 Хидротехнички објекти, 20718 Енергетско искористување на водите, 20719 Организација и економика во градежништвото и водостопанството, 20720 Друго.

5. Бројот на студенти кои можат да бидат запишани во прва година, на наведената студиска програма од точка 1 на ова решение изнесува **25** студенти.

6. Ова решение е конечно и влегува во сила со денот на донесувањето.

Në bazë të nenit 48 paragrafi (2) pika 6, nenit 145 paragrafi (2) dhe nenit 227 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 178/21), Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e **17-të** mbajtur më **5. V. 2021** solli:

# AKTVENDIM

## për akreditimin e programit studimor „Ndërtimtari", cikli i dytë i studimeve akademike - studime pasdiplomike (60 SETK), të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara në Universitetin e Tetovës

1. Akreditohet programi studimor **„Ndërtimtari"**, cikli i dytë i studimeve akademike - studime pasdiplomike (60 SETK), të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara në Universitetin e Tetovës, në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë*, Dekretin për normat dhe standardet për themelimin e institucionit të lartë arsimor dhe kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/10, 168/10 dhe 10/11) dhe Klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit (e dhënë si Shtojcë 1 të Dekretit të theksuar.)

2. Akreditimi i programit studimor nga pika 1 e këtij vendimi është për periudhën prej pesë vitesh studimore duke filluar nga viti akademik **2021/2022**.

3. Pas mbarimit të studimeve në programin studimor të pikës 1 të këtij vendimi, studenti fiton 60 SETK kredi dhe merr titullin akademik: **Magjistër i shkencave teknike nga fusha e ndërtimtarisë** / në qarkullimin ndërkombëtar titullin akademik: **Master of Sciences in Civil Engineering.**

4. Sfera shkencore-hulumtuese: 2 Shkencat tekniko-teknologjike
Fusha shkencore-hulumtuese: 207 Ndërtimtari dhe menaxhimi me ujërat
Lëmia shkencore-hulumtuese: 20700 Materialet ndërtimore, 20701 Gjeomekanika, 20702 Konstruksionet ndërtimore në ndërtimin e ulët dhe ndërtimin e lartë, 20703 Inxhinieria e tërmeteve, 20704 Ndërveprimi (Interakcioni) kompjuterik në projektimin dhe ndërtimin e objekteve, 20705 Mekanika e trupave të ngurtë dhe deformabile, 20706 Teoria e konstruksioneve, 20707 Konstruksionet e çelikut, 20708 Konstruksione e betonit, betonit të armuar dhe paranderur, 20709 Rrugët dhe aeroportet, 20711 Tunelet, 20712 Hidrologjia, 20713 Hidraulika, 20714 Hidroteknika komunale dhe mbrojtja e ujërave, 20715 Rregullimi i rrjedhjeve ujore dhe mbrojtja nga erozioni, 20716 Meliorimet Hidroteknike, 20717 Objektet hidroteknike, 20718 Shfrytëzimi energjetik i ujërave, 20719 Organizimi dhe ekonomia në ndërtimtari dhe menaxhim të ujit, 20720 Tjetër.

5. Numri i studentëve që mund të regjistrohen në vitin e parë të programit studimor të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi është **25** studentë.

6. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e miratimit.

**РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
**АГЕНЦИЈА ЗА КВАЛИТЕТ ВО ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ**
**ОДБОР ЗА АКРЕДИТАЦИЈА НА ВИСОКОТО ОБРАЗОВАНИЕ**

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**
**AGJENCIA PËR CILËSI NË ARSIMIN E LARTË**
**BORDI PËR AKREDITIM I ARSIMIT TË LARTË**

**Образложение**

По предходно донесената Одлука бр. **02-1085/4** од **26.3.2021** година од страна на Сенатот на Универзитет во Тетово, за усвојување на Студиската програма **„Градежништво"**, втор циклус на академски студии - постдипломски студии (60 ЕКТС), на Факултетот за применети науки при Универзитет во Тетово, до Агенцијата за квалитет во високото образование, односно Одборот за акредитација на високото образование, достави барање со нивен бр. **17-221/4** од **29.3.2021** година (наш бр. **08-349/1** од **31.3.2021** година) за прифаќање на елаборат, односно за акредитација на предметната студиска програма.

Одборот за акредитација на високото образование, орган на Агенцијата за квалитет во високото образование, на **15-та** седница, одржана на **7.4.2021** година, формира Стручна комисија за разгледување на барањето за акредитација, со придружната документација и подготвување на извештај по однос на барањето и документацијата.

Врз основа на позитивната оценка содржана во Извештајот на Стручната комисија, бр. **08-349/6** од **21.5.2021** година, согласно Законот за високото образование*, Уредбата за нормативите и стандардите за основање на високообразовни установи и за вршење високообразовна дејност („Службен весник на Република Македонија" бр. 103/10, 168/10 и 10/11) и Класификацијата на научно-истражувачки подрачја, полиња и области, според Меѓународната фраскатиева класификација и Правилникот за организацијата, работата, начинот на одлучување, методологијата за акредитација и евалуација, стандардите за акредитација и евалуација, како и други прашања во врска со работата на Одборот за акредитација и евалуација на високото образование („Службен весник на Република Македонија" бр. 151/12), Одборот за акредитација на високото образование, на својата **17-та** седница, одржана на **5.5.2021** година, одлучи како во диспозитивот на ова решение.

**Правна поука:** Решението за акредитација на Студиската програма е конечно и против него може да се поднесе тужба до Управниот суд.

Претседател
на Одборот за акредитација на високото образование

**проф. д-р Татјана Стојаноска Иванова**

**Arsyetim**

Pas Vendimit të miratuar më parë nr. **02-1085/4** i datës **26. III. 2021** nga ana e Senatit të Universitetit të Tetovës, për miratim të programit studimor **„Ndërtimtari"**, cikli i dytë i studimeve akademie - studime pasdiplomike (60 SETK), të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara në Universitetin e Tetovës, deri te Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë, përkatësisht Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë dorëzoi kërkesë me nr. e tyre **17-221/4** i datës **29. III. 2021** (nr. ynë **08-349/1** i datës **31. III. 2021)** për pranimin e elaboratit, përkatësisht akreditimin e programit studimor në fjalë.

Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë, organ i Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë, në mbledhjen e **15-të** të mbajtur më **7. IV. 2021**, formoi Komision Profesional për shqyrtimin e kërkesës për akreditim me dokumentacionin e bashkëngjitur dhe përgatitjen e raportit lidhur me kërkesën dhe dokumentacionin.

Bazuar në vlerësimin pozitiv që përmban Raporti i Komisionit Profesional, nr. **08-349/6** i datës **21. V. 2021**, në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë*, Dekretin për normat dhe standardet për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dhe kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/10, 168/10 dhe 10/11) dhe Klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit dhe Rregulloren për organizimin, punën, mënyrën e vendosjes, metodologjinë e akreditimit dhe evaluimit, standardet e akreditimit dhe evaluimit, si dhe çështje tjera në lidhje me punën e Bordit të Akreditimit dhe Evaluimit të Arsimit të Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 151/12), Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë, në mbledhjen e **17-të** mbajtur më **5. V. 2021**, vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

**Këshillë juridike:** Aktvendimi për akreditimin e programit studimor është përfundimtar dhe kundër tij mund të dorëzohet padi në Gjykatën Administrative.

Kryetar
i Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë